

Ujë të pastër për të gjithë

“Ndotja e ujit e ka zvogëluar qasjen në ujë të pijshëm dhe e ka rrezikuar jetën e shumë gjallesave që jetojnë në ujë. Medoemos duhet të ndërmerren masa të rrepta dhe të mundësohet qëndrueshmëri më e mirë e jetës së gjallesave që jetojnë në ujë si dhe të ekosistemit në tërësi.”

Kolins Abalu

Arsimtar në shkollën e mesme Ladela
Abuxha, Nigeri

Ujë të pastër për të gjithë

Lënda

Shkencë, gjeografi

Rezultatet mësimi

Deri në fund të mësimi nxënësit duhet të mund:

- ta definojnë ndotjen e ujit
- t'i njohin disa nga shkaktarët e ndotjes së ajrit
- t'i përshkruajnë pabarazitë globale për qasje në ujë të pastër

Përgatitja

- Përgatitni dy gota me ujë (njërën mbusheni me ujë të ndotur, ndërsa tjetrën me ujë të pastër). Përkujdesuni që të mund të shihni ujin qartë.
- Shfaqni në projektor ose shtypni fotografi të trupave të ndotur dhe të pastër të ujit – shih shtojca 1
- Shtypni fletën në të cilën janë dhënë shkaqet e ndotjes së ajrit (shtojca 2)
- Projektoni ose shtypni hartën (shtojca 3)
- Mundësoni që nxënësit të kenë qasje në hartën e botës

Koha

60 minuta

Mosha

8-14 vjeç

Ujë të pastër për të gjithë

Aktiviteti mësimor

5 minuta

Mbushni dy gota me ujë (njërën mbusheni me ujë të pastër ndërsa tjetrën me ujë të ndotur ose të turbullt.

Zbatoni parimin *mendoni, punoni në çifte dhe ndani me të tjerët*. Kërkoni nga nxënësit të tregojnë nëse kanë vërejtur ndonjë dallim ndërmjet dy gotave. Nëse po, atëherë pyetni cilat janë ato dallime. Nëse do të duhej të zgjedhin ndërmjet dy gotave, cila gotë sipas tyre do të ishte e sigurt për të pirë, e cila nuk do të ishte. Pse? Cili do të ishte efekti i mundshëm i pirjes nga njëra ose nga gotë tjetër?

Para se nxënësit të përgjigjen me zë në pyetjet e parashtruara, jepuni atyre një minutë në dispozicion që të mendojnë në heshtje. Pastaj ndani ata në çifte, që t'i krahasojnë idetë dhe observimet e tyre me partnerin e çiftit. Në fund kërkoni nga nxënësit t'i ndajnë përgjigjet e tyre me klasën.

Diferencimi dhe alternativat

Në vend se të zbatoni aktivitetin *mendoni, punoni në çifte dhe ndani me të tjerët*, le t'i shënojnë nxënësit përgjigjet dhe observimet e tyre në zhurnalin e tyre te shkencës ose në ndonjë copë fletë. Ruani zhurnalët/fletët për në fund të mësimin, ashtu që nxënësit do të mund të reflektojnë për atë që e kanë mësuar dhe parë. Shihni nëse do të ndryshojnë ndonjëra nga përgjigjet e tyre.

Aktiviteti mësimor

10 minuta

Shpjegoni dhe/ose prezantoni definicionin e ndotjes së ajrit. P.sh. “**Ndotja e ujit** ngjan kur çfarëdo qoftë burimi i ujit (lumenj, liqene, oqeanë) përzihen me substanca të dëmshme për qeniet e gjalla.” Duhet të shpjegoni se jo gjithnjë mund ta shihni ndotjen e ujit.

Shfaqni fotografi të trupave të pastër të ujit dhe trupave të ndotur të ujit (shtojca 1). Kërkoni nga nxënësit t'i krahasojnë fotografitë, çfarë fjalë do të përdorin gjatë përshkrimit të fotografive? Nxënësit le të vendosin se cilat fotografi sipas tyre paraqesin ujë të ndotur e cilat paraqesin ujë të pastër.

Diferencimi dhe alternativat

Nxënësit po ashtu mund të parashtrojnë pyetje në lidhje me fotografitë e ujit të ndotur.

Aktiviteti mësimor

15 minuta

Ndani nxënësve shtojcën 2 dhe kërkoni nga ata t'i lexojnë shkaqet e ndotjes së ajrit. Diskutoni në çifte se çka konsiderojnë të jetë shkaku kryesor i ndotjes së ajrit. Nxënësit më pas i radhisin shkaqet, duke u nisur nga shkaku më i madh deri te shkaku më i vogël i ndotjes së ajrit (qoftë duke u prerë dhe klasifikuar ose duke i shënuar në copë letre ose në zhurnalët e tyre).

Ujë të pastër për të gjithë

Poenta është që nxënësit të mendojnë rreth shkaqeve të ndryshme dhe të jenë të gatshëm t'i shpjegojnë zgjedhjet e tyre sesa vetëm të kenë përgjigje të sakta. Pyetni disa nxënës t'i ndajnë idetë e tyre me klasën.

Aktiviteti mësimor

25 minuta

Anekënd botës ka shumë njerëz që nga arsye më të ndryshme nuk kanë qasje në ujë të pastër. Ndotja e ujit është vetëm njëra ndër arsyet.

Ndajuni hartën e botës në fletë ose shfaqeni në ekran (projektor), në të cilën është paraqitur uji i pijshëm anekënd botës (shtojca 3)

Shpjegoni se harta tregon se në cilin rajon të botës njerëzit kanë qasje në ujë të pastër.

Kërkoni nga nxënësit të përgjigjen në këta pyetje, ndoshta atyre iu nevojitet harta standarde e botës (shtojca 4), në të cilën janë dhënë emrat e shteteve:

- Ku është shteti i tyre? Ku gjendet ai në hartën e ujit të pastër? (Shtojca 3)
- Ku janë shtetet me qasje të mirë në ujë të pijshëm? Përdorni emrat e kontinenteve dhe drejtimin e kompasit në përgjigjet tuaja?
- Ku gjenden shtetet me më pak qasje në ujë të pastër? Përdorni emrat e kontinenteve dhe kahjet e kompasit në përgjigjet tuaja?
- Sa është e barabartë qasja në ujë të pastër anekënd botës? A është e njëjtë për të gjithë?

Aktiviteti mësimor

5 minuta

Vlerësoni (evaluoni) mësimin duke i pyetur nxënësit ta shënojnë një pyetje e cila iu kujtohet, kur e shikojnë hartën (ose ta vënë nga një shënim dhe ta ngjisin përpara klasës). Shihni nëse nxënësit tjerë mund t'iu ndihmojnë të gjejnë përgjigje në pyetjen e tyre, përdorni ato për hulumtim në shtëpi, ose përdorni si bazë për mësim të ardhme në këtë temë.

Nëse ke kohë në fillim të mësimit përkujtojuani nxënësve përgjigjet e pyetjeve të tyre. Çka mendojnë ata se do të jenë pasojat e pirjes së ujit të ndotur?

Ndërmerrni masa për Qëllimet globale

Si edukator keni fuqinë t'i kanalizoni energjitë pozitive të nxënësve dhe t'iu ndihmoni atyre të besojnë se nuk janë të pafuqishëm, se ndryshimi është i mundshëm dhe se ata vetë mund ta drejtojnë atë.

Projekti për ndryshim "Unë mund t'iu dal ballë sfidave" i fton fëmijët të ndërmarrin veprime, të bëjnë ndryshime për moshatarët e tyre dhe t'i ndajnë ato me fëmijët anekënd botës.

Vizitoni www.dfcworld.com që të filloni

Për të zbritur një pako mësimesh të *projektit për ndryshim*, gjegjësisht një pako të thjeshtë këshillëdhënëse me të cilën të rinjtë do të mund të marrin ndonjë veprim vizitoni www.globalgoals.org/worldslargestlesson

Ujë të pastër për të gjithë

Ujë të pastër për të gjithë

SHKAQET E NDOTJES SË UJIT

Hedhja e mbeturinave, të cilat më pas i ndotin përroska dhe lumenjtë	Përbërjet dhe mbeturinat kimike që i ndotin përroskat dhe lumenjtë	Deponimi në tokë i përbërjeve të dëmshme kimike, të cilat nganjëherë futen në ujësjellës.
Përbërje kimike nga miniera që i ndotin përroska dhe lumenjtë	Uji i nxehtë i industrisë, që derdhet në përroska dhe lumenj	Qeset e hedhura të plastikut, të cilat përfundojnë në oqean
Toka e larë në përroska dhe lumenj pas shirave të mëdha	Copëza të dëmshme në ajër të përziera me shi. Këta copëza lirohen nga automjetet, avionët dhe lëndët djegëse nga fosilet që përdoren për prodhim të energjisë elektrike	Përbërje nga larjet dhe pastrimet në shtëpi, të cilat nga gypat derdhen në lumenj.
Ngjyrat për rroba, të derdhura në përroska dhe lumenj	Ujërat e zeza të papastra dhe të patrajtura nga tualetet, të cilat përzihen me pajisjet për ujë të pastër.	Kafshët të cilat e përdorin ujin e njëjtë me njerëzit. Mbeturinat e tyre përzihen me ujë.
Derdhja e naftës nga anijet në oqean.	Mbeturinat e hedhura në liqene dhe oqeanë	Yndyra nga gatimi i ushqimit që derdhet në lavamanë

Ujë të pastër për të gjithë

Proporcioni i popullatës

<50

50-75

76-90

.90

Nuk ka të dhëna

Nuk janë të zbatueshme

Foto: Harta për qasje në ujë anekënd botës, e matur si përqindje e njerëzve me qasje në burime të përmirësuara të ujit të pijshëm si nga viti 2001. Burimi: Organizata Botërore e Shëndetësisë.

Ujë të pastër për të gjithë

MAP

Kufijtë dhe emrat e paraqitur si dhe skicat e përdora në këtë hartë nuk nënkuptojnë vijat e miratuara të kufijve nga Organizata e Kombeve të Bashkuara.

Kufijtë përfundimtar ndërmjet Republikës së Sudanit dhe Republikës së Sudanit Jugor ende nuk janë përcaktuar.

Vijat e ndërprera e paraqesin *Vijën e kontrollit në Xhammu dhe Kashmir* të miratuar mes Indisë dhe Pakistanit. Statusi përfundimtar i *Xhammusë dhe Kashmirit* ende nuk është miratuar nga palët përkatëse.

*** Pa paragjykim për çështjen e sovranitetit.*

***Ekziston kontest ndërmjet Qeverive të Argjentinës dhe Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut në lidhje me ishujt Falkland (Malvinas)*

Inicialet në kllapa i referohen pushtetit administrativ ose pushtetit të përfshirë në marrëdhënie të marrëveshjes së posaçme